



Goldwood Primary School

21600 Center Ridge Road • Rocky River • Ohio 44116
440.356.6720 • rosiak.carol@rrcs.org • www.rrcs.org
Carol Rosiak, Ed.D., Drejtoreshë

Të nderuar familjarë,

Kemi kënaqësinë të njoftojmë se Goldwood Primary School i janë akorduar përsëri këtë vit fondet e Titullit I. Nxënësit që kualifikohen në "Goldwood" do të marrin shërbime shtesë ndërhyrëse për aftësitë në lexim. Nëse fëmija juaj zgjidhet për të marrë pjesë në këtë program, do të njoftoheni nga mësuesi i fëmijës suaj.

Kjo letër ka për qëllim të informojë të gjithë prindërit/kujdestarët e nxënësve të cilët ndjekin shkollën tonë që është pjesë e Titullit I, se ju keni të drejtë të informoheni rreth kualifikimeve për mësimdhënie të mësuesit të klasës së fëmijës suaj. Sipas legjislacionit federal, drejtoritë arsimore që marrin fondet e Titullit I duhet të informojnë prindërit për të drejtën për të pyetur rreth kualifikimeve të mësuesit të klasës së fëmijës së tyre. Këto kualifikime përfshijnë:

- Nëse mësuesi përmbush kriteret e licencimit të mësuesve në Ohio për nivelin e klasës dhe lëndët që mësuesi jep mësim - *mund të qëndroni të qetë pasi të gjithë anëtarët e stafit të "Goldwood" i kanë përmbushur/tejkalluar kriteret e licencimit të mësuesve në Ohio.*
- Nëse mësuesi jep mësim në kushte emergjence ose përkohësisht, ku nuk nevojitet të përmbushen kriteret shtetërore për licencim - *asnjë nga anëtarët e stafit të "Goldwood" nuk jep mësim në këto rrethana.*
- Degën ku mësuesi është diplomuar dhe çdo diplomë ose certifikim tjetër universitar të mësuesit dhe fushën e disiplinës së certifikimit ose diplomës - *të gjithë mësuesit tanë janë shumë të kualifikuar për të dhënë mësim në detyrat e tyre në nivel fillor.*
- Nëse fëmijës suaj i ofrohen shërbime nga mësues ndihmës dhe, nëse po, kualifikimet e tyre - *asnjë nga fëmijët që janë pjesë e programit të Titullit I nuk do të ndiqen nga mësuesit ndihmës, përveç rastit kur ata kanë gjithashtu një I.E.P (Program Edukimi të Individualizuar) me ato specifika.*

Nëse keni pyetje për ndonjë nga informacionet e dhëna, ju lutem më telefononi në numrin e listuar më sipër.

Me respekt,

Carol Rosiak, Ed.D.